LIGJ
Nr.10 088, datë 2.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHTESË TË KONVENTËS PËR LEHTËSITË DOGANORE PËR TURIZMIN, NË LIDHJE ME IMPORTIMIN E DOKUMENTEVE E TË MATERIALEVE PUBLICITARE TURISTIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të konventës për lehtësitë doganore për turizmin, në lidhje me importimin e dokumenteve e të materialeve publicitare turistike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6095, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLLI SHTESË

I KONVENTËS[1] MBI LEHTËSIRAT DOGANORE PËR TURIZMIN, NË LIDHJE ME IMPORTIMIN E DOKUMENTEVE DHE MATERIALEVE PUBLICITARE TURISTIKE, HARTUAR NË NJU-JORK MË 4 QERSHOR 1954

Shtetet kontraktuese,

në kohën e përfundimit të një konvente mbi formalitetet doganore për turizmin, nga konferenca e kombeve të bashkuara mbi formalitetet doganore për importimin e përkohshëm të automjeteve private dhe për turizmin,

me dëshirën për të lehtësuar edhe qarkullimin e dokumenteve dhe materialeve publicitare turistike,

kanë rënë dakord mbi dispozitat shtesë të mëposhtme:

Neni 1

Për qëllimin e këtij protokolli, termi "tarifat e importit dhe taksat e importit" nuk do të nënkuptojnë vetëm tarifat doganore, por edhe të gjitha tarifat dhe taksat, të çfarëdo lloji, të vendosura për arsye importimi.

---

1. Në përputhje me nenin 10, protokolli hyri në fuqi më 28 qershor 1956, ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit ose pranimit, dhe më pas, për çdo shtet ratifikimin dhe pranimin pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit ose pranimit, në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga këto shtete të instrumenteve të tyre të ratifikimit ose pranimit.
Në vijim është lista e ratifikimeve dhe pranimeve (a) duke treguar datat e depozitimit dhe hyrjes në fuqi të Protokollit:

Shteti	Data e depozitimit	Data e hyrjes në fuqi
Belgjikë	21 shkurt 1955	28 qershor 1956

(Gjithashtu e aplikueshme në territorin e Kongos Belge dhe territorin e Trustit të Ruanda-Urundit)		
Japoni	7 shtator 1955	28 qershor 1956
Danimarkë (a)	13 tetor 1955	28 qershor 1956
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda Veriore (Objekt i vërejtjeve të regjistruara në aktin final; shih fq.204)	27 shkurt 1956	28 qershor 1956
Austria	30 mars 1956	28 qershor 1956
Zvicra	23 maj 1956	21 gusht 1956
Luksemburgu	21 nëntor 1956	19 shkurt 1957
India (a)	15 shkurt 1957	16 maj 1957
Egjipti	4 prill 1957	3 korrik 1957
Suedia	11 qershor 1957	9 shtator 1957
Meksika	13 qershor 1957	11 shtator 1957
Izraeli (a)	1 gusht 1957	30 tetor 1957

Shtrirje e protokollit shtesë tek territoret që vijojnë u njoftua nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut më 7 gusht 1957 (për veprim më 5 nëntor 1957);

Borneo e Veriut, Qiproja, Xhamajka, Federata e Malajës, Malta, Sejshells, Siera Leone, Singapori, Protektorati Somalian, Tonga, Zanzibari.

*Shih faqen 230 të këtij volumi.

Neni 2

Çdo shtet kontraktues duhet të pranojë heqjen e tatimeve dhe taksave të importit për artikujt e mëposhtëm, në qoftë se ata janë importuar nga një shtet tjetër kontraktues dhe nuk përbëjnë asnjë rrezik për abuzim:

a) Dokumente (dosje, pamflete, libra, revista, guida, postera me dhe pa kornizë, fotografi pa kornizë dhe fotografi të zmadhuara, harta të ose të pailustruara, diapozitivë) për shpërndarje falas, qëllimi kryesor i të cilave është inkurajimi i publikut për të vizituar shtete të tjera, ndër të tjera, për të marrë pjesë në takime apo demonstrime kulturore, turistike, sportive, fetare dhe profesionale, të zhvilluara në këto vende, në qoftë se dokumentet nuk përmbajnë më shumë se 25% material privat reklamues komercial dhe janë padyshim të projektuara për qëllime të përgjithshme publiciteti;

b) Listat dhe librat vjetorë të hoteleve të huaja, të publikuar ose të sponsorizuar nga agjenci zyrtare turistike dhe oraret e shërbimeve të transportit që operojnë jashtë vendit, kur dokumente të tilla janë për shpërndarje falas dhe nuk përmbajnë më shumë se 25% material reklamues komercial;

c) Materiale teknike që u dërgohen përfaqësuesve të akredituar ose korrespondentëve të emëruar nga agjencitë turistike zyrtare kombëtare, jo për qëllime shpërndarjeje, për shembull kalendarë, numratorë telefonikë, lista hotelesh, katalogë panairesh, modele punimesh me dorë të një vlere të papërfillshme, dokumente rreth muzeumeve, universiteteve, llixhave dhe institucioneve të ngjashme.

Neni 3

Duke iu nënshtruar kushteve të paraqitura në nenin 4, tarifat e importit dhe taksat e importit duhet të hiqen përkohësisht për materialet që vijojnë, pa lidhur kontrata përsa u përket këtyre tarifave apo taksave apo duke depozituar këto tarifa dhe taksa, kur importohen nga një shtet kontraktuese kryesisht me qëllim që të inkurajojë publikun për të vizituar atë Shtet; ndër të tjera, për të marrë pjesë në takimet dhe demonstrimet kulturore, turistike, sportive, fetare ose profesionale, që zhvillohen në atë vend.

a) Materialet me qëllim ekspozimin në zyrat e përfaqësuesve të akredituar ose korrespondentëve të emëruar nga agjencitë zyrtare kombëtare turistike ose në vende të tjera të miratuara nga autoritetet doganore të vendit për import: piktura dhe vizatime, fotografi me kornizë dhe fotografi të zmadhuara, libra arti, piktura, gdhendje dhe litografë, skulptura dhe tapiceri dhe punime të tjera artistike;

b) Materiale ekspozimi (vitrina, tezga dhe artikuj të ngjashëm), ku përfshihen pajisje elektrike dhe mekanike të nevojshme për të realizuar këtë ekspozim;

c) Filmat dokumentarë, filmime, incizime dhe regjistrime të tjera zëri, të planifikuara për përdorim në performanca, për të cilat nuk duhet të paguhet ndonjë detyrim, por duke përjashtuar ato raste kur subjektet e të cilave janë të përshtatshme për hua për reklamim tregtar dhe ato që janë në shitje të zakonshme në vendin e importimit;

d) Një numër i arsyeshëm flamurësh;

e) Diorama, bocete, projektorë, blloqe printimi, negativë filmash fotografikë;

f) Mostra, në një numër të arsyeshëm, punime artizanale kombëtare, kostume lokale dhe artikuj të ngjashëm folklori.

Neni 4

1. Lehtësirat e përmendura në nenin 3 duhet të jepen në kushtet e mëposhtme:

a) Materiali duhet të dërgohet ose nga një agjenci turistike zyrtare, ose nga një agjenci publiciteti turistike kombëtare të varur nga ajo. Prova duhet të sigurohet duke paraqitur te autoritetet doganore të shtetit të importit një deklaratë të përgatitur në përputhje me modelin në aneksin e këtij protokolli nga agjencia dërguese.

b) Materiali duhet të importohet për dhe me përgjegjësinë ose të përfaqësuesit të akredituar të agjencisë turistike zyrtare kombëtare të vendit që bën dërgesën, ose të korrespondentit të caktuar nga agjencia e sipërpërmendur dhe e miratuar nga autoritetet doganore të shtetit të importimit. Përgjegjësia e përfaqësuesit të akredituar për korrespondentin e miratuar përfshin në veçanti pagesën e tarifave dhe taksave të importit, të cilat vendosen, në qoftë se kushtet e parashtruara në këtë protokoll nuk përmbushen.

c) Materiali i importuar duhet të rieksportohet pa ndryshime nga agjencia importuese. Në qoftë se materiali që është lejuar të pranohet pa pagesë shkatërrohet, sipas kushteve të parashtruara nga autoritetet doganore, importuesit duhet t'i hiqet detyrimi për të rieksportuar.

2. Privilegji i pranimit të përkohshëm pa pagesë do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej të paktën dymbëdhjetë muajsh.

Neni 5

Në rast mashtrimi, shkeljeje ose abuzimi, shtetet kontraktuese do të jenë të lira të procedojnë për shlyerjen e tarifave të importit dhe taksave korresponduese të importit, si dhe për të vendosur gjoba mbi personat përgjegjës, të cilëve u janë bërë përjashtime ose lehtësira të tjera.

*Shih faqen 282 të këtij volumi, nr.3992

Neni 6

Çdo shkelje e dispozitave të këtij protokolli, çdo zëvendësim, deklaratë e rreme ose akti që ka efektin t'i sjellë një personi apo një artikulli përfitime të padrejta nga sistemi i importimit të përcaktuar në këtë protokoll, mund t'i ngarkojë shkelësit në shtetin, ku është kryer shkelja, përgjegjësinë të paguajë gjobat e parashikuara nga ligjet e shtetit ku është kryer vepra penale.

Neni 7

1. Shtetet kontraktuese nuk duhet të ndërmarrin vendosjen e ndonjë mase ndaluese të karakterit ekonomik në lidhje me materialin e referuar në protokollin e paraqitur, si dhe të heqin gradualisht masat e kësaj natyre, të cilat mund të jenë ende në fuqi.

2. Dispozitat e protokollit të paraqitur nuk duhet të cenojnë në asnjë mënyrë zbatimin e

ligjeve dhe rregullave në lidhje me importimin e artikujve të caktuar, kur ligje dhe rregulla të tilla caktojnë masa ndaluese, të cilat bazohen mbi konsiderata të moralit publik, sigurisë publike, shëndetit publik ose higjenës.

Neni 8

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1954 në emër të çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe çdo shteti tjetër të ftuar të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi formalitetet doganore për importimin e përkohshëm të automjeteve private dhe për turizmin, mbajtur në Nju-Jork në qershor 1954, që më poshtë do të referohet si Konferenca.

2. Ky Protokoll do të jetë objekt ratifikimi dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 9

1. Që nga 1 janari 1955, ky protokoll do të jetë i hapur për pranim nga çdo shtet i përmendur në paragrafin e parë të nenit 8 dhe çdo shtet tjetër të ftuar nga Këshilli Ekonomik-Social i Kombeve të Bashkuara. Ai do të jetë gjithashtu i hapur për pranim në emër të ndonjë territori trust, ku Kombet e Bashkuara janë autoriteti administrues.

2. Pranimi do të kryhet nga depozitimi i një instrumenti pranimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë që nga data e depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit apo pranimit ose pa rezervë, ose me rezervat e pranuara në përputhje me nenin 14.

2. Për çdo shtet që ratifikon apo pranon protokollin pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit apo pranimit në përputhje me paragrafin e mësipërm, protokolli do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit apo pranimit nga ky shtet, ose pa rezervë, ose me rezervat e pranuara në përputhje me nenin 14.

Neni 11

1. Tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij protokolli, çdo shtet kontraktues mund ta denoncojë atë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm e Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të jetë i vlefshëm pesëmbëdhjetë muaj nga data kur Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njoftohet për denoncimin.

Neni 12

Ky protokoll nuk do të ketë më efekt, në qoftë se për ndonjë periudhë dymbëdhjetëmujore që vijon nga hyrja në fuqi, numri i shteteve kontraktuese do të jetë më pak se dy.

Neni 13

1. Në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo pranimit ose në çdo periudhë kohore vijuese, çdo shtet mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që ky protokoll do të zgjerohet në të gjithë ose ndonjë nga territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës. Protokolli do të zgjerohet në territoret e përmendura në lajmërim, që nga dita e nëntëdhjetë pasi është dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në qoftë se njoftimi nuk është shoqëruar me një rezervë, ose nga dita e nëntëdhjetë pasi njoftimi është bërë i vlefshëm në përputhje me nenin 14, ose në datën në të

cilën protokolli ka hyrë në fuqi në shtetin përkatës, pavarësisht se cili është i fundit.

2. Çdo shtet që ka lëshuar një deklaratë sipas paragrafit vijues, duke e zgjeruar këtë protokoll në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të denoncojë protokollin veçmas, sipas atij territori, në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 14

1. Rezervat për këtë protokoll, të bëra para nënshkrimit të aktit final duhet të jenë të lejueshme, në qoftë se janë pranuar nga shumica e anëtarëve të Konferencës dhe të regjistruara në aktin final.

2. Rezervat e bëra pas nënshkrimit të aktit final nuk do të jenë të lejueshme, në qoftë se një e treta e shteteve nënshkruese ose shteteve kontraktuese shprehin mospëlqim për sa vijon.

3. Teksti i çdo rezerve të dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara nga një shtet në kohën e nënshkrimit, depozitimi i një instrumenti ratifikimi apo pranimi sipas nenit 13 do të qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm te të gjitha shtetet që do ta kenë nënshkruar, ratifikuar apo pranuar protokollin deri në atë kohë. Në qoftë se një e treta e këtyre shteteve shpreh mospëlqim brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e qarkullimit, rezerva nuk do të pranohet. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet e referuara në këtë paragraf për çdo mospëlqim që ai ka marrë, si dhe rreth pranimit apo refuzimit të rezervës.

4. Çdo mospëlqim nga një shtet që ka nënshkruar, por jo ratifikuar protokollin, nuk do të jetë më i vlefshëm, në qoftë se brenda një periudhe nëntëmujore nga data e refuzimit të tij, shteti refuzues nuk e ka ratifikuar protokollin. Në qoftë se, si rezultat i një refuzimi që nuk është më i vlefshëm, një rezervë pranohet në zbatim të paragrafit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të informojë shtetet të cilave iu referohet ky paragraf. Teksti i çdo rezerve nuk duhet të qarkullohet te ndonjë shtet nënshkrues sipas paragrafit të mësipërm, në qoftë se ai shtet nuk e ka ratifikuar protokollin brenda tre vjetësh nga data e nënshkrimit në emër të tij.

5. Brenda periudhës 12-mujore që nga dita kur Sekretari i Përgjithshëm, duke iu referuar paragrafit 3, njofton se rezerva është refuzuar në përputhje me një procedurë të përcaktuar për të në këtë paragraf, shteti që paraqet rezervën, mund të tërheqë rezervën, sipas së cilës instrumenti i ratifikimit, pranimit, apo lajmërimit, bazuar në nenin 13, mund të jetë i vlefshëm për këtë shtet, që nga data e tërheqjes. Në pritje të kësaj tërheqjeje, qoftë instrumenti, qoftë lajmërimi, nuk do të jetë më i vlefshëm derisa rezerva të pranohet duke zbatuar dispozitat e paragrafit 4.

6. Rezervat e pranuara në përputhje me këtë nen mund të tërhiqen në çdo kohë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

7. Asnjë nga shtetet kontraktuese nuk do të kërkohet të zgjerohet në një shtet duke e kthyer rezervën në përfitim të dispozitave, mbi të cilat zbatohet një rezervë e tillë. Çdo shtet që përfiton nga kjo e drejtë duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm sipas rrethanave dhe ky i fundit duhet t'ua komunikojë këtë vendim të gjitha shteteve nënshkruese dhe kontraktuese.

---

*Shih faqen 192 të këtij volumi

Neni 15

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy apo më shumë shtetesh kontraktuese, përsa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij protokolli duhet, për sa të jetë e mundur, të zgjidhet me negociata midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje, e cila nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të paraqitet për arbitrazh, në qoftë se një nga shtetet në konflikt e kërkon këtë dhe do t'u referohet me radhë një apo më shumë arbitrave të zgjedhur me marrëveshje midis shteteve në konflikt. Në qoftë se brenda tre muajsh nga data e kërkesës për arbitrazh, shtetet në konflikt nuk arrijnë të bien dakord për zgjedhjen e arbitrit, apo arbitrave një nga këto shtete mund t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të emërojë një arbitër të vetëm, të cilit mund t'i referohet për vendim mosmarrëveshja.

3. Vendimi i arbitrit apo arbitrave të caktuar sipas paragrafit të mësipërm duhet të jetë detyrues mbi shtetet kontraktuese në fjalë.

Neni 16

1. Tre vjet pasi ky protokoll të ketë hyrë në fuqi, çdo shtet kontraktues, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, kërkon mbledhjen e një konference me qëllim rishikimin e protokollit. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha shtetet kontraktuese rreth kërkesës dhe konferenca e rishikimit duhet të mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm në qoftë se brenda një periudhe katërmujore që nga data e njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se gjysma e shteteve kontraktuese e lajmërojnë atë për pajtimin e tyre me kërkesën.

2. Në qoftë se një konferencë zhvillohet në përputhje me paragrafin e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha shtetet kontraktuese dhe t'i ftojë ata të dorëzojnë brenda një periudhe tremujore propozime, të cilat ata do të dëshironin që Konferenca t'i merrte në konsideratë. Sekretari i Përgjithshëm duhet t'u shpërndajë të gjitha shteteve kontraktues agjendën provizore të konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve, të paktën tre muaj para datës kur do të mblidhet konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të ftojë në çdo konferencë të zhvilluar sipas këtij neni të gjitha shtetet kontraktuese dhe të gjitha shtetet anëtare të tjera të Kombeve të Bashkuara, ose të secilës nga agjencitë e specializuara.

Neni 17

1. Çdo shtet kontraktues mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë protokoll. Teksti i çdo amendamenti duhet të transmetohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet ta qarkullojë atë tek të gjitha shtetet kontraktuese.

2. Çdo amendament i propozuar, i qarkulluar në përputhje me paragrafin e mësipërm, duhet të çmohet i pranuar, në qoftë se asnjë nga shtetet kontraktuese nuk shpreh kundërshtime brenda një periudhe gjashtëmujore, duke vijuar nga data e shpërndarjes së amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë sa më parë të jetë e mundur të gjitha shtetet kontraktuese, në qoftë se është shprehur ndonjë refuzim për amendamentin e propozuar, dhe në qoftë se nuk është shprehur asnjë refuzim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet kontraktuese tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore, caktuar në paragrafin e mësipërm.

Neni 18

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftojë të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha shtetet e tjera të ftuara të marrin pjesë në konferencën mbi:

a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet e marra në përputhje me nenet 8 dhe 9;

b) datën në të cilën ky protokoll do të hyjë në fuqi, në bazë të nenit 10;

c) denoncimet e marra në përputhje me nenin 11;

d) shfuqizimin e këtij protokolli në përputhje me nenin 12;

e) njoftimet e marra në bazë të nenit 13;

f) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti në përputhje me nenin 17.

Neni 19

Origjinali i këtij protokolli duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili duhet të transmetojë kopje të certifikuara të tij tek të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe tek të gjitha shtetet e tjerë të ftuara në konferencë.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Nju-Jork, më katër qershor, njëmijë e nëntë qind e pesëdhjetë e katër, në një kopje të vetme, në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle; çdo tekst i njëjtë me origjinalin.

Sekretarit të Përgjithshëm i kërkohet të përgatisë një përkthim besnik me origjinalin të këtij protokolli në gjuhët kineze dhe ruse, si dhe të shtojë tekstet në gjuhët ruse dhe kineze te tekstet në

gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle, kur të transmetojë kopjet e certifikuara tek shtetet në përputhje me nenin 19 të këtij protokolli.

ANEKSI
MODELI I DEKLARATËS
(Për t'u plotësuar në gjuhën e shtetit eksportues me një përkthim në anglisht ose frëngjisht)

DEKLARATË

Për pranimin e përkohshëm pa pagesë të materialeve turistike publicitare, pa lidhur kontratë për tarifat e importit dhe taksat e importit apo depozitimit të tarifave dhe taksave të tilla

(Emri i organizatës) që dërgon materialin publicitar turistik, adresuar përfaqësuesit të saj të akreditуar (ose korrespondentit të miratuar), emri i të cilit është shkruar më poshtë, për import të përkohshëm, me kushtin që ai do të rieksportohet brenda një periudhe dymbëdhjetëmujore dhe që do të përdoret vetëm me qëllimin e nxitjes së turistëve, për të vizituar shtetin ku eksportohet materiali.

(Emri i organizatës) nuk merr përsipër, qoftë pa pagesë, qoftë me pagesë, që të eliminojë artikujt e importuar përkohësisht pa miratimin e administratës doganore të shtetit që importon materialin, si dhe pa plotësuar të gjitha formalitetet e kërkuara nga administrata.

Këto materiale importohen përkohësisht me përgjegjësi dhe kundrejt garancisë së përfaqësuesit të akreditуar apo korrespondentit të miratuar, emri i të cilit është shënuar më poshtë.

a) Lista e materialeve:

---

b) Emri dhe adresa e përfaqësuesit të akreditуar ose korrespodentit të miratuar, tek i cili do të dorëzohet materiali:

[Data, firma dhe vula e agjencisë zyrtare kombëtare
turistike të shtetit që bën dërgesën]

Për Afganistanin:
Për Shqipërinë:
Për Argjentinën:
Luis J. Estevarena
Për Australinë:
Për Austrinë: Dr. J. Stangelberger
Për Mbretërinë e Belgjikës:

Objekt ratifikimi
Ch. Hopchet

Për Bolivinë:
Për Brazilin:
Për Bullgarinë:
Për Bashkimin e Burmas:
Për Republikën Socialiste të Sovjetit Bjellorus:
Për Kamboxhian:

Iem Kadul

Për Kanadanë:
Për Ceilonin:
Për Kilin:
Për Kinën:
Për Kolumbinë
Për Kosta Rikën:

Për shqyrtim
J. F. Carballo
20 korrik 1954

Për Kubën:

Jose Miguel Ribas
O. Nodarse, tetor 12/54

Për Çekosllovakinë:
Për Danimarkën:
Për Republikën Domenikane:

Për Ekuadorin:

B. Oquendo

Për Egjiptin:

Rachad Mourad

Për El Salvadorin:
Për Etiopinë:
Për Finlandën:
Për Francën:

Filipe de Seynes

Për Republikën Federale të Gjermanisë:

Richard Paulig
Walter Wagner

Për Greqinë:
Për Guatemalën:

Për Haitin:

Ernest G. Chauvet

Për Hondurasin:

Tiburcio Carias Jr.
15 qershor 1954

Për Hungarinë:
Për Islandën:
Për Indinë:
Për Indonezinë:
Për Iranin:
Për Irakun:
Për Irlandën:
Për Izraelin:
Për Italinë:

Ugo Calderoni

Për Japoninë:

Renzo Sawada
2 dhjetor 1954

Për Mbretërinë Hashemite të Jordanisë:
Për Republikën e Koresë:
Për Laosin:

Për Libanin:
Për Liberinë:
Për Libinë:

Për Principatën e Madhe të Luksemburgut

Objekt ratifikimi
J. Kremer
6.12.1954

Për Meksikën:

Jose A. Bufort

Për Monakon:

Marcel A. Palmaro

Për Nepalin:
Për Mbretërinë e Holandës:

Paymans

Për Zelandën e Re:
Për Nikaraguan:

Për Mbretërinë e Norvegjisë:
Për Pakistanin:

Për Panamanë:

Për shqyrtim
Ernesto de la Ossa

Për Paraguain:
Për Perunë:
Për Republikën e Filipineve:

Mauro Mendez

Për Poloninë:
Për Portugalinë:
Për Rumaninë:
Për San Marinon:
Për Arabinë Saudite:
Për Spanjën:
Për Suedinë:

G. De Sydow

Për Zvicrën:

Fr. Luthi

Për Sirinë:
Për Tailandën:
Për Turqinë:
Për Republikën Socialiste Sovjetike të Ukrainës:
Për Bashkimin e Afrikës së Jugut:
Për Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike:

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën Veriore:

Objekt i vërejtjeve të shënuara në aktin final
Charli Henri Blake

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:
Për Uruguain:

Për shqyrtim
E. Rodriguez Fabregat

Për Qytetin e Vatikanit:

Monsinjor Tomas J. McMahon

Për Venezuelën:
Për Vietnamin:
Për Jemenin:
Për Jugosllavinë: